

**RAPORTI PARAPRAK I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS I
PROJEKTIT "NDERTIMI I UJESJELLESIT TE FSHATRAVE, KLOS,
SELVIAS, QYRKAN, LUMAS, FLOQ (Nj.A. KLOS) DHE
RIKONSTRUKSIONI I UJESJELLESIT TE FSHATIT SELITE (Nj.A.
MOLLAS)"
BASHKIA CËRRIK**



RAPORTI I VLERESIMIT TE NDIKIMI NE MJEDIS U PERGATIT NGA:

“ZENIT & CO” SH.P.K. & “ZETAKONSULT” SH.P.K

Ekspert Mjedisi: Yzeir Miraka

INVESTITOR: BASHKIA CËRRIK

TIRANE, 2024

PERMBAJTJA

1. Hyrje	4
2. Kuadri ligjor dhe administrativ i kryerjes se vlersimit te ndikimit ne mjedis	7
2.1 Qëllimi I Hartimit te Raportit te Vlerësimit te Ndikimit ne Mjedis.....	7
3.1 2.2 Kuadri Politiko-Administrativ.....	7
2.3 Kuadri Ligjor	8
3. Permbledhje e projektit teknik	11
3.1 Përshkrimi i Gjendjes Egzistuese	
3.2 Qëllimi i Projektit.....	
3.3 Zgjidhja Teknike e Projektit	
4. Pershkrimi I mjedisit fizik ne zone.....	16
4.1 Pershkrimi i Zones Gjeografike.....	Error! Bookmark not defined.
4.2 Popullsia	
4.3 Punesimi	
4.4 Zhvillimi ekonomik.....	
4.5 Mireqenia ekonomik dhe sociale	
4.6 Burimet natyrore dhe qëndrueshmëria mjedisore	
5. Vleresimi i ndikimeve ne mjedis	20
5.1 Te pergjithshme	20
5.2 Ndikimet tek njerzit dhe objektet e ndertuara nga njeriu	20
5.3 Ndikimet e dukshme te projektit ne zonat rrethuese dhe pejsazh.....	20
5.4 Nivelet dhe ndikimet e emetimeve te ardhura nga zhvillimi i projektit gjate fazës normale te operimit	20
5.5 Niveli dhe ndikimi i zhurmave nga ndertimi i projektit	21
5.6 Ndikimet e projektit ne rruget lokale dhe te transportit.....	21
5.7 Ndikimi i projektit mbi ndertimet, trashëgimine arkitektonike dhe historike, tiparet arkeologjike si dhe mbi veprat e tjera njerëzore.....	21
5.8 Ndikimi mbi floren dhe faunen.....	21
5.9 Humbja dhe demtimi tipareve gjeologjik, paleontologjike, probleme te mjedisit gjeologjik.....	21
5.10 Pershkrimi i ndikimeve negative individuale dhe te grumbulluara ne biodiversitet duke perfshire ndikimet nderkombetare.....	22
5.11 Ndikimet fizike te projektit ne ndryshimet e topografise lokale, erozionit te tokes e tjera	22
5.12 Ndikimet e emetimeve kimike dhe depozitimeve ne toke	22
5.13 Ndikimet ne perdorimin e tokes	22
5.14 Mbetjet e inerte te krijuara gjate fazes se ndertimit.....	22
6. Masat per eleminimin, zvogelimin e ndikimeve	23
6.1 Masat per ndikimet nga zhurmat.....	23
6.2 Masat per ndikimet ne ajer	23
6.3 Ndikimet ne toke.....	24

6.4	Masat per ndikimet ne ujera	24
6.5	Masat per minimizimin e gjenerimit te mbetjve te ngurta	24
6.6	Sistemet Elektrike	24
6.7	Monitorimi dhe Respektimit i Parametrave	24
7.	Konkluzione	25

1. Hyrje

Në këtë raport paraqitet Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për objektin: "NDERTIMI I UJESJELLESIT TE FSHATRAVE, KLOS, SELVIAS, QYRKAN, LUMAS, FLOQ (Nj.A. KLOS) DHE RIKONSTRUKSIONI I UJESJELLESIT TE FSHATIT SELITE (Nj.A. MOLLAS)", BASHKIA CERRIK.

Fshatrat te cilet bejne pjese ne kete projekt nuk kane rrjet ujesjellesi, me perjashtim te fshatit Selite ndersa ne fshatrat e tjere banoret furnizohen nepermjet puseve apo burimeve private, te cilet nuk garantojne cilesi per ujin. Ujesjellesi i ri parashikon:

Hapjen e dy puseve ne afërsi të lumit Devoll, ne fshatin Selvias.

Ndertimin e nje depoje grumbulluse 250 m³, ne fshatin Selvias.

Ndertimin e nje stacioni pompash, i cili do te sherbej per furnizimin e depos 250m³ ne fshatin Selvias, nga e cila marrin uje dhe tre depot e tjera, te pozicionuara ne fshatin Lumas, fshatin Qyrkan dhe ne fshatin Klos.

Ndertimin e tre depove b/a perkatesisht: 100m³ ne fshatin Lumas, 100m³ ne fshatin Qyrkan dhe 200m³ ne fshatin Klos.

Ndertimin e linjes kryesore nga stacioni i pompave ne rezervuarin Selvias.

Ndertimin e nje linje kryesore te re me tuba polietilene PE100RC qe do te furnizoje me uje me renie te lire rezervuarin 100m³ ne fshatin Lumas.

Ndertimin e nje linje kryesore te re me tuba polietilene PE100RC qe do te furnizoje me uje me renie te lire rezervuarin 100m³ ne fshatin Qyrkan.

Ndertimin e nje linje kryesore te re me tuba polietilene PE100RC qe do te furnizoje me uje me renie te lire rezervuarin 200m³ ne fshatin Klos.

Hapjen e nje pusi ne afërsi të lumit Devoll, ne fshatin Floq.

Ndertimin e nje depoje 100 m³, ne fshatin Floq.

Ndertimin e nje stacioni pompash, i cili do te sherbej per furnizimin e depos 100m³ ne fshatin Floq

Ndertimin e linjes kryesore nga stacioni i pompave ne rezervuarin Floq.


Ndertimin e linjes kryesore nga stacioni i pompave ne rezervuarin Selite.

Ndertimin e dhomes se manovrimit per depon e fshatit Selite.

Ndertimin e rrjetit shperndares komplet te ri me tubacione polietilene me desitet te larte PE100 RC me presion PN 10 bar per fshatrat Klos, Selvias, Qyrkan, Lumas, Floq dhe fshatin Selite.

Ndertimin e pusetave te matesave te ujit individuale, ne te cilen do te instalohen matesat per cdo abonentfamiljar.

Vendosjen e tubave PE100 PN10 100 DN 25 per lidhjet familjareve nga rrjeti shperndares deri te puseta e matesave (kufiri i prones se shtepise te secilit abonent).



Planimetria e pergjithshme e rrjetit te ujesjellesit Klos,Selvias,Qyrkan dhe Lumas

Qëllimi kryesor i këtij studimi është të identifikojë ndikimet e mundshme të projektit mbi mjedisin dhe të këshillojë mbi masat e lehtësimit mjedisor dhe planin e monitorimit gjate fazes se ndertimit te objektit ne fjale. Ky dokument siguron pajtueshmërinë me legjislacionin Shqiptar mbi VNM si dhe me politikat zhvillimore të Bashkise Cërrrik.

Raporti i vlerësimit te ndikimit ne mjedis perfshin indentifikimin, saktesimin dhe vleresimin e drejtperdrejt dhe te tërthor te projektit ne mjedisin ku do te zbatohet, si dhe percaktimi i masave per te parandaluar dhe zbutur demtimet ne mjedis.

Ky vleresim i ndikimit ne mjedis do te paraqes nje informacion te shkurter te projektit qe do te realizohet, ndikimet pozitive dhe negative ne mjedis dhe masat qe investitori do te marre per zbatimin e kriterëve te nevojshme per mbrotjen dhe menaxhimin sa me racional te mjedisit.

Theksojme se shume nga vleresimet e detajuara te ndikimeve te mjedisit mbeshteten ne informacionet inxhinierike qe duhet te merren parasysh. Vleresimi identifikon ne menyre te qarte si perfitimet pozitive edhe negative dhe percakton rezultate per secilen prej tyre. Vleresimi identifikon nese ndikimet jane mesatare te pranueshme, te rendesishme, te terthorte apo te drejperdrejta.

2. Kuadri ligjor dhe administrativ i kryerjes se vlersimit te ndikimit ne mjedis

Për raportin e VNM-se të Objektivit: *Ndertimi i ujesjellesit per fshatrat Klos, Selvias, Qyrkan, Lumas, Floq te cilet bejne pjese ne Njesine Administrative Klos dhe rikonstruksionin e rrjetit te ujesjellesit fshati Selite Njesia Administrative Mollas (Bashkia Cërrrik)*. Aplikimi është bërë ne mbeshetje te Ligjit Nr. 12/2015 "Per disa ndryshime ne ligjin nr. 10 440, date: 07.07.2011, "Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis" dhe VKM Nr. 686, date 29.7.2015 "Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis dhe procedures se transferimit te vendimit e deklarates mjedisore" **Shtojca II** Projektet qe i nënshtrohen PROCEDURËS PARAPRAKE TE VLERËSIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS: **Pika 10** : Prodhime infrastrukturore, pika **g**) Instalime të kanaleve ujësjetllës.

2.1 Qëllimi I Hartimit te Raportit te Vlerësimit te Ndikimit ne Mjedis

Qëllimi kryesor i këtij vlerësimi është te identifikojmë efektet e mundshme ne mjedis para zhvillimit te zonës ne studim, gjate dhe mbrapa përfundimit te punimeve; marrja e masave te domosdoshme për minimizimin dhe parandalimin e efekteve te krijuara ne mjedis nga vënia ne jete e këtij projekti.

Me kërkesë te Invenstitorit dhe ne përputhje me kërkesat e projektit te paraqitur po nga ai, u përpilua nga ana jone detyra e studimit te VNM-se, zbatimit te se cilës i kushtohet ky raport.

5.1.2.2 Kuadri Politiko-Administrativ

Vendi ynë është Anëtare i një numri Konventash Ndërkombëtare, si rrjedhoje është i detyruar te zbatoj një sistem sa me efektiv ne fushat Ekonomik-Social-Mjedisor, për rregullimin e Territorit sidomos ne funksion te zgjidhjes se problemeve te ndryshme mjedisore. "Mjedisi është burimi i gjithçkaje për te cilën njerëzit kane nevojë për te jetuar dhe për tu zhvilluar". Tre janë elementet qe i nevojiten një Kombi: Njerëzit, Burimet ekonomike dhe Mjedisi ku jetojnë. Këto janë te lidhur shume me njërin-tjetrin dhe nuk bëjnë dot pa to. Sa me i degraduar te jete mjedisi aq me keq ndikon ne shëndetin e njeriut dhe zhvillimin ekonomik-social. Prandaj duhet një menaxhim sa me mire i këtyre tre faktorëve. Studimi i bere per kete qellim ka objektiv:

- Te mbroje Mjedisin.
- Krijimin e një strukturë Urbane me orientim Ekologjik.
- Te ruaj burimet natyrore dhe tiparet e Peizazhit.
- Te ndërtoje një infrastrukture inxhinierie për te gjithë zonën e studuar si element baze për mbrojtën e Mjedisit.

- Marrja parasysh te zonave me karakter historik dhe veçori te spikatura ambientale dhe te peizazhit, duke specifikuar vendin ku do te studiojmë nga planet Lokale, Parqe Natyrore, zona te Mbrojtura.

Elemente qe parashikon normativa ne drejtim te Vlerësimit te Ndikimit ne Mjedis. Raporti i Vlerësimit te Ndikimit ne Mjedis (VNM) duke u bazuar ne zhvillim strategjik te Bashkise Cërrrik përfshin Planifikimin, Rehabilitimin dhe Masat zbutëse te ndikimit te projektit ne këtë zone.

2.3 Kuadri Ligjor

Gjate dhjetëvjeçarit te fundit qeveria ka realizuar zhvillimin e akteve ligjore mjedisore, si rezultat i ndryshimeve degraduese mjedisore te cilat kane ardhur si rezultat i industrisë para viteve 90-te dhe zhvillimeve te fundit. Bazuar ne nenin 11 te Ligjin Nr. 10440, date 7.7.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit ne Mjedis"

Menaxhimi dhe mbrojta e mjedisit janë pjese e Legjislacionit Shqiptar, Neni 59(d) shkruhet se:

- Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve qe disponon, si dhe ne plotësimin e nismës dhe te përgjegjësisë private, synon:
- Një Mjedis te shëndetshëm dhe Ekologjikisht te Pershtatshem per brezat e sotem dhe te ardhshem.
- Legjislacioni kerkon qe Kondicionet Urbane te shfrytezohen ne perputhje me principe te bazuara.

Kapitulli II "Politikat Mjedisore" percakton politiken e qeverise per:

- Politika Shtetëror Mjedisor percakton pozicionin e mjedisit ne Legjisiacion, vendin e strategjive te sektoreve Kombetar dhe planet lokale si pjese e politikës mjedisore dhe percakton organizmat te cilet do te administrojne keto politika.

Programet dhe strategjitë mjedisore: Percakton planin e veprimit kombetar te mjedisit (PVKM) i cili duhet te hartoj cdo dhjete vjet nje raport mjedisor ne zbatimin e PVKM per Keshillimin e Ministrave.

- Plani lokale mjedisore: kerkojne nga qeveria lokale te zhvillojne Planet Lokale te Veprimit te Mjedisit(PLVM) duke perdorur Organizmat Kombetar per te ofruar te dhena dhe mbeshtetje teknike; per Qeverit Lokale qe te lidhen me publikun , OJF dhe Biznesin per zhvillimin e planeve, kryetaret e Bashkive te raportojne ne Keshillin e Rretheve per Zbatimin e planeve ne fund te vitit.

Pergatitja e ketij raporti te VNM-se kerkon me domosdoshmeri respektimin e Paketës Ligjore Mjedisore, ku me poshte po permendim me kryesoret qe jane marre ne konsiderat gjate pergatitjen e ketij material!.

- Ligji Nr. 10431, date, 09.06.2011 "Per mbrojtjen e mjedisit" (ndryshuar)
- Ligji Nr. 10440 date, 07.07.2011 "Per vleresimin e ndikimit ne mjedis" (ndryshuar)
- Ligji Nr.9010, date, 13.02.2003 "Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta".
- Ligji Nr.10448 date, 14.07.2011, ``Per lejet e mjedisit``
- Ligji Nr.10266, date, 15.04.2010 "Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja``
- Ligji Nr.9587, datë 20.07.2006, "Për mbrojtjen e biodiversitetit"
- Ligji Nr.10463,datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar te mbetjeve" (ndryshuar)
- Ligji Nr.9115 datë 24.07.2003, "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura".
- Ligj nr. 9048, datë 07.04.2003 "Për trashëgiminë kulturore"
- LIGJ Nr. 107/2014, datë 31.7.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"
- Ligjin nr.10 319, datë 16.9.2010 "Për urbanistikën i ndryshuar"
- Ligji Nr. 81/2017 "Për zonat e mbrojtura"
- Ligjin nr.10324, datë 23.9.2010 "Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit"
- Ligji Nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore"
- Ligji Nr.9774, datë 12.7.2007 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis"
- Vendim nr. 686, datë 29.7.2015 për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (vnm) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore.
- Vendimi i Keshillit te Ministrave (VKM) Nr. 435, datë 12.9.2002 "Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë"
- VKM nr.419 date 25.6.2014 « Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A,B dhe C per trans.ferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mejdisit si dhe rregullave te hollesishme per shyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja.
- VKM Nr.459, datë 16.6.2010 " Për miratimin e standardeve të përbashkëta gjeodezike dhe gis"
- VKM nr.574, datë 14.7.2010 "Per miratimin e rregullores se urbanistikes"
- VKM, nr. 99, datë 18.2.2005 " Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve"
- VKM Nr. 1189, datë 18.11.2009, "Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit.
- VKM Nr.247 date 30.04.2014``Per percaktimin e rregullave, te kerkesave e te procedurave per informimin dhe perfshirjen e publikut ne vendimarrjen mjedisore``.
- VKM Nr. 177, datë 31.3.2005 "Për normat e lejuara të shkarkimeve të lengëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse"
- VENDIM Nr.16, datë 4.1.2012 "Për të drejtën e publikut për të pasur informacion mjedisor"
- Vendim nr 417, datë 25.06.2014 "Për miratimin e tarifave të lejeve të mjedisit"
- Vendimi i Keshillit te Ministrave (VKM) Nr. 435, datë 12.9.2002 "Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë"

- Udhëzim i Ministrisë së Mjedisit nr. 3, dt 17.08.2004 "Mbi vlerat e lejueshme të elementeve ndotës të ajrit në mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe të zhurmave shkarkuar nga mjetet rugore dhe mënyrat e kontrollimit të tyre".
- Rregullore nr. 1, datë 30.3.2007 " Për trajtimin e mbetjeve të ndërtimit nga krijimi, transportimi e deri tek asgjësimi i tyre ”.
- Nder vendimet me kryesore theksojme VENDIM Nr. 686, datë 29.7.2015 Për Miratimin E Rregullave, Të Përgjegjësive e të Afateve Për Zhvillimin E Procedurës Së Vlerësimit Të Ndikimit Në Mjedis (Vnm) Dhe Procedurës Së Transferimit Të Vendimit E Deklaratës Mjedisore.
- Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 7, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave
- *(Ky vendim synon të bëjë përafrimin e plotë të Direktivës 2011/92/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 13 dhjetor 2011, "Për vlerësimin e ndikimeve që shkaktohen në mjedis nga projekte publike dhe private" (celex-32011L0092, OJ. L 26, 28.1.2012), të ndryshuar me Direktivën 2014/52/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 16 prill 2014 (celex-32014L0052, OJ. L 124, 25.4.2014).)*

3. Permbledhje e projektit teknik

3.1. Situata aktuale

3.1 Skema operacionale aktuale.

Fshatrat Klos, Selvias, Qyrkan Lumas dhe Floq bejne pjese ne Njesine Administrative Klos (Bashkia Cërrrik). Ne keto fshatra nuk ka rrjet te furnizimit me uje. Uji qe perdorin disa nga banoret aktualisht eshte uje pusi i patrajtuar. Hartimi dhe zbatimi i projektit per rrjetin shperndares dhe ate transmetues te ujesjellesit do ti jap fund mungeses se ujit te pijshem per keto fshatra.

Per fshatin Selite te njesise administrative Mollas ka rrjet ujesjellesi por eshte teper i amortizuar dhe kerkon nderhyrje totale.

3.2 Projekti

Uji qe furnizon fshatrat Klos, Selvias, Qyrkan dhe Floq do te merret nga puset me ane te pompave, te cilat do e dergojne ujin ne nje depon 250 m³ ne fshatin Selvias. Nga depoja 250m³ dalin tre linja transmetimi, njera me tubacion 75 PE 100 PN20 RC per ne fshatin Lumas, njera me tubacion 75 PE 100 PN16 RC per ne fshatin Qyrkan dhe tjetra me tubacion 90 PE 100 PN20 RC ne fshatin Klos.

Per fshatin Selite uji do te merret nga pusi ekzistues dhe me ane te pompave te reja qe do te instalohen ne pus do te furnizohet depo ekzistuese Selite.

Do te ndertohet rrjeti shperndares komplet te ri pef fshatrat Klos, Selvias, Qyrkan, Lumas, Floq dhe Selite. Tubacionet do te jene polietilene me desitet te larte, HDPE 100, Pn 10 bar.

Do te vendosen kaseta me matesave individual, ne te cilat do te instalohen matesat per cdo abonent familjar.

Do te ndertohet rrjeti komplet i ri, per lidhjet e familiareve, nga puseta e matesave deri te kufiri i prones se shtepise te sejcilit abonent. Tubacionet e rrjetit familjar do te jene polietilene HDPE 100, Dn 25 Pn 10.

Furnizimi i konsumatoreve me uje, do te jete ne perputhje me legjislacionin Shqiptar dhe me kriteret minimale te meposhteme :

Furnizim me uje do te jete 24 ore me presion te mjaftueshem , cilesi te ujit ne perputhje me standartet Shqiptare dhe te Komunitetit European EU.

Presioni i ujit te cdo abonent familjar do te jete jo me i vogel se 2 bar dhe jo me i madh se 6 bar.

Sistemi eshte projektuar bazuar ne Standardin EN 805 "Kerkesat per sistemet dhe perberesit jashte godines".

3.2.1 Kërkesa per uje

Kërkesa per uje eshte llogaritur ne kontekst me studimin e plote te terrenit, te dhenave te marre nga autoritet lokale si dhe te dhenave te mbledhura ne sheshin e ndertimit.

3.2.2 Llogaritja e kërkeses per uje per fshatrat Linas, Kamunah, Mollas dhe Dasar

PARASHIKIMI I POPULLSISE				
	Popullsia aktuale	No =	3,352	banor
	Perqindja e rritjes	p =	0.54	%
	Numri i viteve	n =	25	vite
	Popullsia e pritur	$Nn = No (1+p)^n =$	3,835	banor
1. POPULLSIA				
	NR. Banoreve	N =	3,835	banor
	Norma per banor	$n_1^{max} =$	150	l/d/banor
	Prurja max. ditore	$Q_{max}^d = \frac{N * n}{1000} =$	575.3	m3/dite
2. BAR dhe RESTORANTE (11 cope)				
	Sip. Totale	S =	550	m2
	Norma per klient (20-50 l/d/m2)		40	l/d/m2
	Prurja max. ditore		22.0	m3/dite
3. SHKOLLA (1 cope)				
	NR. Nxenesve	N =	141	nxenes
	Norma per nxenes (20-40 l/d/n)		40	l/d/nxenes
	Prurja max. ditore		5.6	m3/dite
4. KOPSHTE & CERDHE (3 cope)				
	NR. Nxenesve	N =	110	femije
	Norma per nxenes (30-60 l/d/n)		50	l/d/femije
	Prurja max. ditore		5.5	m3/dite
6. AMBULANCA (4 cope)				
	NR. Shtreterve	N =	4	pacient
	Norma per shtrat (128 l/d/sh)		128	l/d/sh
	Prurja max. ditore		0.5	m3/dite

7.	BLEKTORI TE TRASHA			
	NR. I krereve	N =	498	krere
	Norma per krere (70 l/d/krere)		70	l/d/krere
	Prurja max. ditore		34.9	m3/dite
8.	BLEKTORI TE IMTA			
	NR. I krereve	N =	1,500	krere
	Norma per krere (15 l/d/krere)		15	l/d/krere
	Prurja max. ditore		22.5	m3/dite
→	Σ e prurjeve max ne m3/dite		666	m3/dite
	Humbjet ne rrjetin e ujsjellesit		20.00	%
→	Σ e prurjeve max ne m3/dite+ humbjet		800	m3/dite
→	Prurja mesatare ditore ne l/s per linjen e dergimit		9.25	l/s


Koficienti i jouniformitetit, ne prurjet e rrjetit shperndares, merret ne konsiderate duke pasur parasysh se ne sistemet me popullsi te vogel k eshte me e larte se ne sistemet e furnizimit me komunitet me te madh.

N° banor.	Qmax/Q(ditore)	Qmax/Q(h)
5000.00	0.13	3.00
10000.00	0.11	2.66
20000.00	0.10	2.40
50000.00	0.08	2.00
100000.00	0.07	1.71
200000.00	0.06	1.50

Sipas eksperiences se pergjithshme, kerkesa me e madhe per uje eshte ne oret e para te dites per kete arsye eshte marre Faktori i ndryshimit $K_p=2.6$.

Ndryshimet sipas kerkeses per uje per 24 ore jane konsideruar ne llogaritjet hidraulike.

Grafiku 4.2.1.1-2 Konsumimi i ujit ne perputhje me faktorin e pikut



3.2.2.1 Dimensionimi i Depove dhe Kerkesat per uje per shuarjen e zjarrit.

Do te ndertohen kater depo te reja. Dy depo 100m³, nje depo 200m³ dhe nje 250m³. Bazuar ne faktin se depot do te furnizohen me nje prurje konstante sa mesatarja ditore orare dhe kerkesa ne rrjet do te jete ne funksion te luhatjes orare eshte llogaritur vellimi i punes se rezervuarit. Me poshte kemi percaktuar llogaritjet per depon 250m³ ne fshatin Selvias.

PERCAKTIMI I VELLIMIT TE REZERVUARIT							
Ko	Oret e dites	% Q_{max}^a					
		Konsumi real	Konsumi real progres	Dhenia burimit	Dhenia burimit progres	Ne rezervuar	
						Hyn/Del	Mbetet progresive
0.4	1	1.67	1.7	4.17	4.17	2.50	2.50
0.4	2	1.67	3.3	4.17	8.33	2.50	5.00
0.4	3	1.67	5.0	4.17	12.50	2.50	7.50
1	4	4.17	9.2	4.17	16.67	0.00	7.50
1	5	4.17	13.3	4.17	20.83	0.00	7.50
1	6	4.17	17.5	4.17	25.00	0.00	7.50
1.3	7	5.42	22.9	4.17	29.17	-1.25	6.25
1.3	8	5.42	28.3	4.17	33.33	-1.25	5.00
1.3	9	5.42	33.7	4.17	37.50	-1.25	3.75
1.2	10	5.00	38.7	4.17	41.67	-0.83	2.92
1.2	11	5.00	43.7	4.17	45.83	-0.83	2.08
1.2	12	5.00	48.7	4.17	50.00	-0.83	1.25
1.2	13	5.00	53.7	4.17	54.17	-0.83	0.42
1.2	14	5.00	58.7	4.17	58.33	-0.83	-0.42
1.2	15	5.00	63.7	4.17	62.50	-0.83	-1.25
1.6	16	6.67	70.4	4.17	66.67	-2.50	-3.75
1.6	17	6.67	77.1	4.17	70.83	-2.50	-6.25
1.6	18	6.67	83.7	4.17	75.00	-2.50	-8.75
0.8	19	3.33	87.1	4.17	79.17	0.83	-7.92
0.8	20	3.33	90.4	4.17	83.33	0.83	-7.08
0.8	21	3.33	93.7	4.17	87.50	0.83	-6.25
0.5	22	2.08	95.8	4.17	91.67	2.08	-4.17
0.5	23	2.08	97.9	4.17	95.83	2.08	-2.08
0.5	24	2.08	100.0	4.17	100.00	2.08	0.00
24.00		100.00		100.00			

$V = \frac{ a + b }{100} * Q_{max}^d$	=	129.92	m3
-----------------------------------------	---	--------	----

Vellimi i rregullimit	=	130	m3
Vellimi i zjarrit 3 ore	=	54	m3
Vellimi i avarise 8 ore	=	61	m3
Vellimi total i depos	=	245	m3

Gjate llogaritjes se volumit te rezervuareve eshte marre ne konsiderate, kerkesa per uje per shuarjen e zjarrit. Llogaritja e rezerves se zjarrit ne rezervuar eshte bere ne baze te VKM nr.162 date 19.04.1965 “Rregullat per mbrojtjen e zjarrit ne projektimin e cdo lloj konstruksioni” e cila percakton volumin e kerkuar te ujit per mbrojtjen nga zjarri, ne vartesi te numrit te banoreve dhe numrit te zjarreve: Gjate hartimit te projektit eshte marre ne konsiderate qe ne zonen tone te sherbimit, eshte parashikuar nje zjarr me sasi uji 4 l/s, me kohe te nevojshme per shuarjen e zjarrit, 2 ore. Sasia e ujit te rezerves se zjarrit ne rezervuar duhet te jete:

5 l/s x 4 ore x 60 min x 60 sek = 72000 litra = 72 m³

3.2.3 Kriteret e projektimit

Sistemi eshte projektuar bazuar ne Standardin EN 805 “Kerkesat per sistemet dhe perberesit jashte godines”.

Kerkesa e prurjes mesatare ditore eshte 32.6 l/s. Koef. i jouniformitetit $K_p=1.4$

Thellesia e ngrirjes 0.4 m. Thellesia minimale e pjeses se siperme te tubit nga siperfaqja e tokes ne linjen kryesore te transmetimit do te jete 1 m.

Thellesia minimale e pjeses se siperme te tubit nga siperfaqja e tokes ne linjen shperndarese te transmetimit do te jete 0.8 m.

Ne linjat e shperndarjes uji leviz me renie te lire. Te gjitha valvolat dhe matesat e ujit do te instalohen ne puseta. Presioni manometrik ne rrjetin e shperndarjes do te jete jo me i vogel se 2 bar dhe jo me i madh se 6 bar.

Valvolat e shkarkimit do te instalohen ne linja ne pikat me kuote me te ulet.

4. Pershkrimi I Mjedisit Fizik Ne Zone

5.2.Vendndodhja

Njesia Administrative Klos dhe Mollas, Qarku Elbasan shtrihet ne jug te qytetit te Elbasanit ne luginen e Devollit , kufizohet ne jug me fshatrat e Kuçoves, ne lindje me Njesine Administrative Sulti te rrethit Gramsh ,ndersa ne perendim me zonen e Dumrese te cilen gjate gjithë kufirit te saj kalon lumi Devoll.

2.2. Klima

Njesia Administrative Klos dhe Mollas ashtu si e gjithë Shqipëria bën pjesë në brezin e klimës mesdhetare, dhe dallohet për tipare më të shprehura mesdhetare, e cila karakterizohet nga vera e nxehtë dhe e thatë me shkëlqim të madh të diellit dhe dimër i butë dhe me rreshje të mëdha. Si matje me te aferta ne kemi ne qytetin e Kuçoves dhe dote mbeshtetemi tek te dhenat mbi kete qytet. Ky qytet ka arritur shifrën rekord në Shqipëri për temperaturën më të larte të regjistruar me 44,4 °C në korrik [1986](#).

Klima e Kuçoves është tipike mesdhetare fushore-kodrinore me dimër të butë e me reshje dhe verë e nxehtë dhe e thatë. Temperatura mesatare vjetore luhet në 15-17°C. Temperatura mesatare e korrikut është 25°C ndërsa ajo e janarit 6°C. Gjatë vitit takohen mbi 60 ditë të nxehta dhe arrihet një temperaturë prej rreth 30°C për 320 orë në vit. Ka mesatarisht 2,500 orë ndriçim diellor në vit dhe 332 ditë me diell. Reshjet mesatare vjetore janë 1,200 mm në vit. Erërat në dimër janë lindore-verilindore dhe të ftohta, dhe vjen nga jugu nga lumi Osum dhe lindja nëpërmjet grykës së Devollit. Ndërsa gjatë verës erërat janë të ngrohta jugperëndimore-veriperëndimore.Zona e Kuçoves përfshin të gjitha zonat klimatike të vendit: në zonën klimatike mesdhetare fushore, mesdhetare kodrinore, mesdhetare paramalore dhe mesdhetare malore. Pjesa më e madhe e saj shtrihet në zonat klimatike kodrinore (nënzona qendrore) dhe shumë pak në zonën klimatike mesdhetare paramalore (nënzona veriore) e ajo klimatike mesdhetare malore (nënzona juglindore). **Bora** në këtë zonë nuk është një dukuri e rrallë pasi ne majate maleve te Shpieagut dhe Tomorrit ajo eshte prezente gjate gjithë dimrit,sipas të dhënave klimatike të IGJEUM. Ndersa ne qytetin e Kuçoves si dhe ne pjesen fushore e kodrinore te saj numri i ditëve me borë gjatë vitit luhet nga 3ditë deri në 5 ditë.

Lagështia e ajrit gjatë vitit luhet në kufirin nga 73% deri në 79%, ndërsa vlera mesatare vjetore e lagështirës është 76%.

Era. Jane nje element me rendesi te madhe gjeografike dhe agrometeorologjike per ultesiren perendimore. Ne rrethin e Kuçoves erërat në dimër janë lindore-verilindore,si dhe jug-lindore dhe të ftohta, dhe vjen nga jugu nepermjet lugines se lumit Osum dhe lindja nëpërmjet grykës së lumit Devollit. Ndërsa gjatë verës erërat janë të ngrohta jugperëndimore-veriperëndimore.

5.3. Topografia

Zona e projektit ka një sipërfaqe prej rreth 600 ha. Ajo shtrihet ne intervalin e kuotave midis 250m dhe 50m. Ky ndryshim kuotash nga depo ne rrjetin shperndares per rregullimin e presioneve ne sejcilen linje detyron perdorimin e valvolave dhe saracineskave prej GIZE. Për zonën e projektit jane bere matje topografike me **GPS SOKKIA GRX2** (gabimi ne pozicion planimetrik $\pm 2-3\text{cm}$, gabimi ne kuote $\pm 2-3\text{cm}$) dhe ndertimi i terrenit digital DEM me pas ne te cilin do te bazohet modelimi i skemës me Software-in WaterCad version V8i (SELECT seria 6).

4.4. Ndertimi gjeologjik dhe hidrologjik

Njesia Administrative Mollas perbehet kryesisht nga depozitime terigjene (ranor, conglomerate, argjile gelqeror etj). *Nga pikpamja e ndertimit hidrogeologjike zona e studimit ton ne Kuçove perfshihet ne Ultesiren Perendimore prane Adriatike UPA ne sektorin qendror te saj dhe shtrihet ne krahun lindore te fushes se Myzeqes me fushe perhapjen e depozitimeve Messiniani*

(N₁³m) - **Plioceni (N₂)** dhe deri te depozitimet me moshe me te re te Kuarternarit i perbere nga depozitime aluviale dhe deluviale. Zona e studiuar ndodhet ne pjesen lindore te sinklinalit te Myzeqese. Baza erozionale e lugines se lumit te Semanit si dhe dy degeve te tij lumi Devoll dhe Lumi Osum.

Keto formacione mbulohen nga Depozitimet e holocenit te hershem – alQh₁ - Depozitimet e holocenit te vonshem –al Qh₂ qe ne kete zone kane trashesi deri ne 20 m.

Pozicioni gjeografik si dhe fusha e Myzeqese qe shtrihet ne perendim te qytetit te Kuçoves, e ndikojnë dukshëm në kushtet klimatike të kësaj zone. Elementët fiziko-gjografike të territorit të rrethit te Kuçoves, gërshtuar me njëri-tjetrin, florën dhe faunën dhurojnë peizazhe dhe bukuri mahnitëse që stimulojnë kryesisht zhvillimin e agrobiznesit dhe buqesis në këtë rajon, si dy burime të rëndësishme të ardhurash për rritjen e mirëqenies dhe prosperitetit të banorëve të këtij rajoni dhe zhvillimin e tij.

4.4.1 Kushte Hidrogeologjike dhe gjeologo inxhinierike

Në rrjetin hidrografik të Kuçoves marin pjese lumenjte Semani, si dhe deget e tij lumi Osum dhe lumi Devoll. Lumi Devollit eshte lumi kryesor që përshkon zonën tonë të studimit nga Korça ne Kuçove deri ne fshatin Arrez ku bashkohet me lumin Osum dhe te dy se bashku formojne lumin Seman deri ne grykderdhjen e tij ne detin Adriatik. Lumi Devoll se bashku me lumin Osum formojne pellgun hidrografik Devoll-Osum ne fushen e Kuçoves(Çiflik,Kozare Arrezt).

Lumi i Osumit - Lumi Osum formohet nga përrenjtë e shumte që rrjedhin nga shpatet e Vithkuqit në malësinë e Korçës dhe shpatet perëndimore te malit te Gramozit në rrethin e Kolonjës. Lumi Osum shtrihet në zonën e mesme të territorit të Shqipërisë me drejtim të përgjithshëm të rrjedhjes Lindje – Perëndim. Prurja mesatare e tij është 32,5 m³/sek. Gjatë rrjedhës se tij neper Skrapar, Osumi bashkohet me disa dege të tjerë te tij dhe formën e vërtete e merr në hyrje te qytetit të Beratit. Osumi pasi bashkohet me Devollin në afërsi të fshatit Arrez,

formojnë lumin Seman. Siperfaqja ujembledhese e lumit te Osumit eshte 2150 km² ndersa lartesia mesatare e tij eshte 828m. Gjatësia e Osumit është 161 kilometra, por pjesa me e bukur e tij është padyshim kanioni që ndodhet në rrethin e Skraparit. Kanioni i Osumit është më i gjati dhe ka lartësinë mesatare më të madhe në vend. Në fundin e tij, në Vaun e Grepckes, Osumi krijon një delte te bukur që shfrytëzohet nga banoret e Çorovodës dhe fshatrave përreth për të pushuar dhe bere plazh gjate stinës se verës. Nga pikëpamja hidrokimike ujërat e lumit Osum ne fushen e Arrzes janë të tipit Hidrokarbonat –Magnezi-Kalçium (HCO₃– Mg– Ca) dhe hidrokarbonat –sulfat-Magnezi-Natriumi(HCO₃ – SO₄ -Mg -Na) me një mineralizim të përgjithshëm Mp= 345 mg/l dhe një fortësi të përgjithshme Fp = 13° ne grade Gjermane.

Lumi i Devollit - Lumi Devoll (196 km) buron në këmbë të Gramozit jashte teritorit te Shqiperise, dhe vazhdon rrjedhën e vet në drejtimin terthor ne pjesen veriore te ultesires prej grykes se Cangonjit ne lindje e deri ne Maliq ne perendim. Lumi i Devollit kalon ne veri ne luginen drejt qytetit të Bilishtit(duke formuar tre tarraca) , për t'u kthyer më pas në perëndim nëpër grykën midis Malit të Thatë në veri dhe Moravës në jug, ku bashkohet në thellësi me lumin Osum, dhe formojnë së bashku Semanin. Siperfaqja ujembledhese është 3.139 km² dhe lartësia mesatare mbi nivelin e detit është rreth 960 m. Në bazë të të dhënave të stacionit hidrometrik të Orman – Pojanit, nivelet dhe prurjet minimale të lumit Devoll, në ultësirën e Korçës takohen në muajt Gusht –Shtator dhe kanë respektivisht vlerat 6-2cm dhe 1.88 –3.11m³/sek, ndërsa vlerat maksimale takohen në muajt Nëntor –Prill dhe kanë vlerat 339 –416 cm dhe 22.9m³/sek. Nga pikëpamja hidrokimike dhe ujrut ujërat e lumit Devoll janë të tipit Hidrokarbonat –Magnezi-Kalçium (HCO₃ – Mg- Ca)me një mineralizim të përgjithshëm Mp= 390 mg/l dhe një fortësi të përgjithshme Fp = 11° ne shkalle Gjermane.

Lumi Seman - Lumi i Semanit është vazhdimi i dy degëve të lumit Osum dhe të lumit Devoll me gjatësi të përgjithshme 281 km, Përshkon me dredhime 61 km në Fier në Fushën e Myzeqesë..Lartësia mesatare e pellgut ujembledhës të lumit **Seman prej 863 m** mbi nivelin e detit tregon se ky lum grumbullon ujërat e një territori të theksuar malor. Vlerat e larta dhe pothuajse të përafërta të lartësive mesatare të pellgjeve ujembledhese të lumenjve **Osum (825 m)** dhe **Devoll(950 m)**, tregojnë se jo vetëm Semani në përgjithësi, por edhe dy afluentët e tij në veçanti, karakterizohen nga e njëjta natyrë malore e konfiguracionit të pellgut ujembledhës.

Në përgjithësi sipërfaqja e pellgjeve ujembledhese të lumenjve afluentë Osum e Devoll, përfshihet në zonën malore dhe kodrinore të pellgut ujembledhës (Seman), ndërsa pjesa fushore fillon rreth zonës së bashkimit të këtyre dy lumenjve afluentë(prane fshatit Arrez) e deri në derdhjen e Semanit në detin Adriatik. Lumi Seman dhe dy afluentët e tij kryesor: lumenjtë Osum dhe Devoll, përshkojnë të gjitha zonat tektonike të Shqipërisë, të cilat karakterizohen nga një strukturë e ndërlikuar me toka të përshkueshme prej 21% të sipërfaqes së përgjithshme të pellgut ujembledhës gjysmë të përshkueshëm prej 51% dhe të pa përshkueshme prej 28%. Të shkruash për historinë e lumit Seman është e pamundur mos të trajtosh historinë e dy degëve të tij kryesore Osumit dhe Devollit. Këta lumenj nisen nga burimet e maleve të Korçës si mali i Gramozit, Malit të Thatë, malet e Voskopojës, malit të Tomorit prurjet e të cilëve rriten derisa dalin në fushë të madhe. Ka të dhëna dhe hipoteza se të dy degët kanë qenë të pavarura deri në derdhjen e tyre në

detin Adriatik. Me vonë të dy degët, Devolli dhe Osumi, duke u bashkuar me njëri-tjetrin kanë marrë drejtimin dhe emrin e rrjedhës së poshtme fundore që është ky i sotëm dhe ruan të njëjtin emër Seman. Bashkimi i dy degëve ka ndodhur rreth viteve 1804–1805 dhe i dhanë emrin që ka dhe sot, Seman. Semani është lumi i dytë për nga gjatësia në Shqipëri pas Drinit. Lumi fillon në rrethin e Kuçoves dhe formohet nga bashkimi i dy lumenjve Osum dhe Devoll në afërsi të fshatit Arrez. Është i gjatë rreth 281 km me pellg ujëmbledhës 5'649 km² dhe lartësi mesatare mbi nivelin e detit 863 m. Pasi përshkruan fushën e Myzeqesë, shkarkon ujërat e tij në detin Adriatik, në jug të lagunës së Karavastasë. Përpara se të arrijë detin Adriatik ai bashkohet me lumin e Gjanicës i cili përshkon përmes qytetit të Fierit. Duke marrë në konsideratë kushtet hidrometeorologjike, ujëmbledhësi i Semanit është më i varfëri nga të gjithë lumenjtë e Shqipërisë, lidhur me ujërat nëntokësore. Gjithashtu, reshjet janë të pakta, mesatarisht **1084 mm/vit**. Prurja mesatare shumëvjeçare e lumit Seman është **95,7m³/s**. ku rreth 60% e ujit sigurohet nga ujëmbledhësi i Devollit. Ujëmbledhësi i Semanit përbëhet nga fusha bujqësore me mbulesë të pakët bimore që i nënshtrohet një erozioni të madh.

Sasia e lëndëve të ngurta që transportohen për në det nga Lumi Seman është afërsisht 31,2 milionë tonë/vit. Në zonën e bashkimit të dy lumenjve në fshatin Arrez, ujërat e lumit Seman nga pikëpamja hidrokimike janë të tipit Hidrokarbonat – Kalçium -Magnezi (HCO_3 –Ca- Mg) dhe Hidrokarbonat –Magnezi-Natriume dhe Kaliumi (HCO_3 –Mg-Na+K). Keto ujra kanë mineralizim relativisht të lartë prej 440 mg/l. Temperaturat e ujit luhaten nga 6–8°C në janar deri në 25,5°C në gusht. Shtrati i lumit është i pasur me zhavorr dhe rërë të imët, me gjerësi nga 100 deri 200 m. Lumi ka gjithmonë ujë të bollshëm, por me rrjedhje relativisht të ngadaltë. Brigjet janë argjilore të veshura me peme. **Semani është ndër lumenjtë më eroziv, duke e bërë lumin me eroziv në vend.**



Fig. 2. Skema e Basenit të lumit

Vleresimi i Ndikimeve ne Mjedis

5.5.Te pergjithshme

Cdo aktivitet qe zhvillohet shoqerohet me pasoja dhe ndikime ne mjedis, qe jane pjese e atij kompromisi qe shoqeria jone ka zgjedhur per tu zhvilluar. Megjithate e rendesishme eshte qe te kuptohet natyra e ketyre proceseve, forma e shfaqjes se tyre dhe me analitikesht ndikimet e cdo operacioni te kryer.

Per vleresimin e ndikimeve ne mjedis te projektit u ndoqen hapat e meposhtme:

- Njohja me proceset e punës
- Njohja me vlerat natyrore dhe mjedisore te zones dhe siperfaqes ku do zhvillohet aktiviteti

Duke analizuar natyren e te gjithe proceseve dhe format e shfaqjes se tyre, direkte ose indirekte, percaktohet qarte lloji i ndikimeve. Te gjitha ndikimet mund te minimizohen ne terma relative ku qellimi kryesor eshte mbajtja e tyre brenda siperfaqes se objektit te kerkuar dhe krijimi i kushteve natyrore per te siguruar riaktivizim te proceseve te natyres dhe rigjenerim te ekosistemit.

5.6.Ndikimet tek njerzit dhe objektet e ndertuara nga njeriu

Si rrjedhoje e zbatimit te projektit per ndertimin e ujesjellesit ne keto njesi Administrative, nuk ka ndikime pasuese mjedisore tek njerzit. Ne ndertimin e ketij projekti nuk jane parashikuar ndryshime ne popullsine e zonës dhe zhvendosjes se saj, per shkak te ketij aktiviteti ndertimor me qellim banimi.

5.7.Ndikimet e dukshme te projektit ne zonat rrethuese dhe peizazh

Projekti nuk ka ndikime negative ne zonen rrethuese. Zbatimi i projektit nuk ndryshon konfiguracionin, topografine e zones dhe pejsazhin e saj. Prandaj nuk do te kete nevojë per reabilitime te dukshme. Pas venies ne shfrytezim te ujesjellesit me aktivitet sherbim ujesjellesi uje te pijshem nuk pritet te kete ndikim ne pejsazhin e zones.

5.8.Nivelet dhe ndikimet e emetimeve te ardhura nga zhvillimi i projektit gjate fazës normale te operimit

Gjate fazes normale te zbatimit te projektit, bazuar ne teknologjine e perdorur nuk do te kete emetime te gazeve, lengjeve, mbetjeve te ngurta toksike dhe lende te tjera te demsheme qe mund te shkarkohen ne ajer dhe ne toke, te cilat mund te ndikojne negativisht ne shendetin e puntoreve, banoreve per rreth, mjedisin floren dhe faunen e zones.

5.9. Niveli dhe ndikimi i zhurmave nga ndertimi i projektit

Gjate fazes te ndertimit nuk do te shkaktohen zhurma me nivel te larte. Niveli i zhurmave eshte brenda normave dhe i pranueshem, per puntoret ashtu dhe per zonen per rreth. Gjithashtu automjetet e transportit jane te paisen me sistemin e amortizimit te zhurmave te motorreve te tyre. Punimet e prishjes dhe germimit do te realizohen jasht orarit te pushimit dhe puntoret te paisen me kufje mbrojtese nga zhurmat.

5.10. Ndikimet e projektit ne rruget lokale dhe te transportit

Makinat e furnizimit me lende te pare te materialeve inerte nuk do te kete ndikim te dukshem ne rruget lokale per faktin se ky subjekt do te kete nje numer shume te kufizuar mjetesh ne pune. Keshtu zhvillimi i projektit nuk do te kete ndikime te dukshme ne rruget lokale dhe nacionale te transportit. Zona ne fjale nuk ka trafik te renduar qe te ndalohe kufizimi i mjeteve te punes ne kantier gjate oreve te ndryshme te dites, pasi vete zona eshte nje zone me nje trafik jo te dendur.

5.11. Ndikimi i projektit mbi ndertimet, trashegimine arkitektonike dhe historike, tiparet arkeologjike si dhe mbi veprat e tjera njerzore

Nga zbatimi i projektit nuk ka dhe nuk do te kete impakt negativ mbi ndertimet, trashegimine arkitektonike dhe historike, tiparet arkeologjike, si dhe mbi vepra te tjera njerzore, sepse ne kete zone dhe per rreth saj , nuk ka objekte te kesaj natyre ose te nje rendesie te vacant te karakterit te mesiperm.

5.12. Ndikimi mbi floren dhe faunen

Kryesisht ne kodrat per rreth objektit, dominojne bime qe rriten ne zonat mesdhetare si barishtet, shkuret, murrizi, dushkqet, ferra, frasheri, driza, plepi ndersa nga bimet frutore dallohen vreshtat, mollet etj. Per organizmat e gjalla do te kete kushte me te mira jetese.

Fauna perfaqesohet:

- Nga zvarraniket si zhapikët dhe gjarpërinj te ndryshëm.
- Nga shpend si harabelat e arave, mellenjat, gushkuqet, bilbilat, dallandyshtet, gargujt, pellumbat.
- Nga Gjitarët perfaqsohen nga ujku, dhelpra, lepuri, nuse lala dhe kafshet shtepiake, etj.

Fauna karakteristike e zones eshte pothuajse e paprekshme nga aktiviteti.

5.13. Humbja dhe demtimi tipareve gjeologjik, paleontologjike, probleme te mjedisit gjeologjik

Nga pikepamja e tipareve gjeologjike dhe paleontologjike, kjo zone nuk ka vecori tipike dalluese dhe nuk ka arsye te vleresohet dhe te merret ne konsiderat gjate projektimit per ndertimin e objektit dhe nuk kerkon ndonje gjeologji te qendrueshme dhe me karakter te vecante te shtresave.

5.14. Pershkrimi i ndikimeve negative individuale dhe te grumbulluara ne biodiversitet duke perfshire ndikimet nderkombetare

Nga zbatimi i projektit, nuk ka dhe nuk jane parashikuar ndikime individuale apo te grumbulluara ne biodiversitet. Objekti eshte ne brendesi te territorit te Republikes se Shqiperise, prandaj dhe nuk ka ndikime nderkufitare .

5.15. Ndikimet fizike te projektit ne ndryshimet e topografise lokale, erozionit te tokes e tjera

Gjate rikonstruksionit te ujesjellesit nuk do te kete ndryshime topografike te siperfaqes se tokes dhe ndikime te erozionit. Shtresat gjeologjike paraqiten te qendrueshme.

5.16. Ndikimet e emetimeve kimike dhe depozitimeve ne toke

Aktiviteti qe do te zhvillohet nuk do te kete efekte te demshme ne toke, me teknologjine e projektuar, nuk ka procese pune qe shoqerohen me derdhje apo shkarkime te mbetjeve te ngurta dhe te lengeta ne toke, apo te gazta ne atmosfere, te elementeve kimike, toksike te demshem per mjedisin qe demtojne floren, faunen dhe shendetin e njerzve.

5.17. Ndikimet ne perdorimin e tokes

Ky aktivitet nuk ka ndikim negative ne perdorimin e tokes, nuk do te perdoret siperfaqe tjeter toke pervec asaj te miratuar nga organet vendim marrese ku kjo eshte prone e vet bashkise Cërrik. Pjesa me e madhe e ujesjellesit do te kaloje ne rruge.

5.18. Mbetjet e inerte te krijuara gjate fazes se ndertimit

Persa i perket mbetjeve inerte eshte vete investitori qe duhet te largoje nga sheshi i ndertimit mbetjet e ngurta qe do te krijohen. Ku ne kete raste eshte sipermarresi i punimeve qe do te largoje mbetjet inerte qe do te gjenrohen ne vendin qe do te percaktoje Bashkia.

5. Masat per Eleminimin, zvogelimin e Ndikimeve

Kerkesat mjedisore qe synojne mbrojtjen e shendetit e te mjedisit, perfshijne specifikimin e kushteve, normave e standarteve te detyrueshme per mbrojtjen e pastertise se ajrit urban , te ujerave siperfaqesore e nentokesore, te cilesise e vlerave te tokes, te territoreve urbane, rrugeve, trotuareve , zonave te gjelberuara. Drejtues te subjektit i cili do te vihet ne shfrytezim,do te marrin ne konsiderate te gjitha masat lehtesuese zbutese per ndikimet ne mjedis.

5.1.Masat per ndikimet nga zhurmat

Në kantjerin e ndertimit , sipermarresi, do te hartojte dhe zbatoje programin e masave për mbrojtjen nga zhurmat, si me poshte:

- Do të respektohen standardet për nivelin e zhurmave;
- Aktivitetet e prishjes, do të kufizohen në orët që sjellin shqetësime për banorët përreth;
- Aktivitetet e germimit dhe ndërtimit do të programohen sipas një grafiku në mënyrë që të evitohet operimi i disa pajisjeve e makinerive në të njëjtën kohë i cili shkakton nivele të larta zhurmash;
- Makinerite e pajisjet e fuqishme të ndërtimit, si dhe ato që gjenerojne zhurma mbi kufijtë e lejuar, do të jenë të pajisura me ekrane mbrojtës për zhurmat.

5.2.Masat per ndikimet ne ajer

Me qëllim qe shkarkimet në ajër që emetohen gjate ndertimit te objektit do te jene vazhdimisht brenda normave të lejuara, subjektit ndërtues, do te marri marrin këto masa:

- Gjate procesit te ndërtimit do të përdoren mbulesa të përkohëshme dhe do të lagen sipas nevojës, një deri dy herë në ditë për të reduktuar çlirimet e pluhurave;
- Për lëvizjen e materialeve në kantier e në sheshin e ndërtimit, do të përdoren konteniere të mbyllur;
- Do të mirëmbahet sheshi i ndërtimit gjatë kryerjes së aktiviteteve të nivelimit, ndërtimit dhe transportit;
- Të gjitha ngarkesat të sigurohen nëpërmjet rregullimit, lagies ose mjete të tjera për të parandaluar derdhjet, rrjedhjet dhe pluhurat;
- Të gjitha materialet e transportuara jashtë sheshit të ndërtimit do të jenë të lagura në mënyrë të mjaftueshme ose të mbuluara mirë;
- Të gjitha aktivitetet e pastrimit, nivelimit, ndërtimit dhe transportit do të ndërpriten gjatë periudhave me erë të fortë;
- Do të kufizohet shpejtësia e lëvizjes së kamionëve në kalimet e sheshit të ndërtimit, deri në 30 km/orë; Gjithashtu edhe kur eshte trafik i renduar nese do te kete ne dite te vecanta.
- Do të vendosen mbulesa mbrojtëse për mbeturinat e ekspozuara ndaj erës;

5.3.Ndikime ne toke

Nuk do te kemi ndikime ne toke, pasi gjurma e rrjetit ujesjelles do te kaloje ne ate egzistues ne pjesen me te madhe, dhe shtresat nentokesore paraqiten te qendrueshme.

5.4.Masat per ndikimet ne ujera

Nuk do e kete ndikime negative ne ujera. Nese gjate punimeve do te kete ndonje shkeputje te apo demtin te rrjetit te kanalizimeve ai do te stabilizohet menjehere per te mos krijuar probleme ne rrjetin e kanalizimeve.

5.5.Masat per minimizimin e gjenerimit te mbetjve te ngurta

Sipermarresi do te administroje mbetjet që gjenerohen nga veprimtaria ndërtuese, duke marre këto masa:

- a. Mbetjet që gjenerohen nga veprimtaria ndertimore, do të sistemohen të ndara e të veçuara sipas llojit të tyre, në vende të paracaktuara që më parë për qëndrimin e tyre provizor;
- b. Mbetjet do të largohen çdo ditë nga sheshi i ndertimit dhe do te dërgohen në vendgrumbullimet e përcaktuara nga Bashkia.
- c. Transportimi i tyre do të bëhet në orët me trafik të pakësuar;
- d. Për transportin e materialeve dhe të mbetjeve do të përdoren makina të mbulura dhe që nuk rrjedhin;
- e. Do të pastrohen menjëherë rrjedhjet, derdhjet, pikimet për të parandaluar ndotjen e tokës;
- f. Do të shtrohen me zhavorr dhe të mirembahen rrugët brenda sheshit të ndërtimit;
- g. Shërbimet dhe riparimet e makinerive e të pajisjeve do të bëhen sipas grafikut dhe në vende të përcaktuara për këtë qëllim;
- h. Do të lahen gomat e automjeteve para daljes nga sheshi i ndërtimit.

5.6.Sistemet Elektrike

Kur eshte e nevojshme per energji elektrike do te perdoret energjia elektrike e rrjetit, por me pare do te komunikohet me OSHEE dhe Bashkine Cërrrik, kjo per arsye te shmangies se ndonje avarie ne rrjet pa demtuar konsumatoret familjare. Gjithashtu do te zbatohen rregullat e sigurimit teknik ne kantierin e punes per te minimizuar cdo aksident ne pune.

5.7.Monitorimi dhe Respektimit i Parametrave

Kryerja e monitorimit gjate procesit te ndertimit objektit synon vecanerisht te respektoje te gjitha normat e shkarkimeve ne ajer, uje dhe toke, duke bere monitorim te sipas nje grafiku te percaktuar.

6. Konkluzione

Projekti nuk parashikohet te kete ndikime te demshme ne mjedis. Ndikimet gjate zbatimit te projektit mund te parandalohen dhe reduktohen ne nivel te pranueshem duke perdorur praktika te njohura inxhinierike dhe masa te tjera shoqerisht te pranueshme. Projekti do te kete ndikim pozitiv ne rritjen nivelit ekonomik te zones, sherbimeve mbeshtetese, etj.

- Perfundimi me i rendesishem eshte se projekti nuk ka ndikime negative ne mjedis, duke qene se eshte nje aktivitet qe nuk krijon premisa per ndotjen e mjedisit apo te sjelle ne mjedis.
- Perfundimi me i rendesishem eshte se projekti nuk ka ndikim te rendesishem ne mjedis. Do te ndertohet ne kryesisht ne rruge. Objekti do te ndertohet me kriteret urbanistike dhe mjedisore, duke respektuar kuadrin ligjor ekzistues. Ky projekt perputhet me planin lokal te Bashkise Cërrik.
- Gjate aktivitetit te ndertimit dhe gjate funksionimit nuk do te shkaktohet ndotje e tokes.
- Me marrjen e masave ne favor te mbrojtjes se mjedisit dhe ato pak elemente, qe mund te kene nje ndikim te perkohshem ne mjedis dhe qe jane permendur me lart do te kapercehen.
- Aktiviteti do te paraqese nje ndikim minimal ne mjedis dhe me zbatimin e masave parandaluese vecanarisht gjate fazes se ndertimit, keto ndikime jane pothuajse fare te vogla.

Si perfundim efektet do te jene positive nga ndertimi i ketij objekti.

RAPORTI I VLERESIMIT TE NDIKIMI NE MJEDIS U PERGATIT NGA:

“ZENIT & CO” SH.P.K. & “ZETAKONSULT” SH.P.K

Ekspert Mjedisi: Yzeir Miraka